

VENDIM
Nr.759, datë 6.12.2005

PËR VLEFSHMËRINË E MARRËVESHJEVE DYPALËSHE, TË NËNSHKRUARA
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË ISH-REPUBLIKËS ÇEKE E SLLOVAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Njohjen si të vlefshme, në marrëdhëniet dypalëshe, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe, të marrëveshjeve dypalëshe, të nënshkruara në nivel ndërshtetëror ose ndërqeveritar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së ish-Republikës Çeke e Sllovaqe, të parashikuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Marrëveshjet dypalëshe, të përmendura në aneksin nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, kanë mbaruar vlefshmërinë e tyre ose kanë humbur qëllimin, për të cilin ato janë përfunduar, shfuqizohen në marrëdhëniet e ndërsjella, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1

Marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Çeke dhe Sllovaqe, të cilat qëndrojnë në fuqi në marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe.

1.Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ish-Republikës së Çekosllovakisë mbi bashkëpunimin kulturor (Tiranë, 1 dhjetor 1952).

2.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi transportin ajror (Tiranë, 30 maj 1958).

3.Konventë konsullore ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës së Çekosllovakisë (Tiranë, 16 janar 1959).

4.Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës së Çekosllovakisë mbi ndihmën për çështjet civile, familjare dhe penale (Pragë, më 16 janar 1959).

5.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi transportin ndërkombëtar rrugor (Pragë, më 7 janar, 1991).

6.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit (Pragë, më 26 nëntor 1991 dhe Tiranë, më 30 nëntor 1991).

Aneksi nr.2

Marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Çeke dhe Sllovaqe, të cilat shfuqizohen në marrëdhëniet reciproke ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe.

1.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë për dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Pragë, 8

shkurt 1956).

2. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Pragë, 8 shkurt 1956).

3. Shtesa e parë e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë të 8 shkurtit 1956 (Tiranë, më 4 qershor 1956).

4. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi kredinë për furnizimin me mallra nga Republika e Çekosllovakisë për Republikën Popullore të Shqipërisë në periudhën 1956-1960 (Pragë, 5 gusht 1957).

5. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin e depozitave të hekur-nikelit në Pishkash- rajoni lindor i Republikës Popullore të Shqipërisë (Tiranë, më 5 maj 1958).

6. Shtesa e dytë e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Tiranë, më 5 maj 1958).

7. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi postat, telegraf dhe telefon-komunikacionin (Pragë, më 23 shtator 1959).

8. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në çështjet doganore (Tiranë, më 17 tetor 1960).

9. Shtojca e shtesës së dytë të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë të shkurtit 1956, nënshkruar në maj 1958 mbi vlerësimin e kobaltit në hekur-nikelin ose shpërndarjen nga Republika Popullore e Shqipërisë në Republikën Socialiste të Çekosllovakisë (Tiranë, më 3 tetor 1973).

10. Protokolli ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi rregullimin e kursit reciprok të këmbimit ndërmjet koronës çekoslloake dhe lekut shqiptar në pagesat jotregtare (Tiranë, më 2 nëntor 1983).

11. Protokolli ndërmjet Ministrisë së Tregtisë së Jashtme të Republikës Popullore të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale të Tregtisë së Jashtme të Republikës Socialiste të Çekosllovakisë mbi kushtet e shpërndarjes së mallrave dhe pagesave ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare për tregtinë e huaj dhe organizatave çekoslloake të autorizuara për ushtrimin e aktivitetit të tregtisë së huaj (Tiranë, më 6 prill 1987).

12. Protokolli ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Çeke dhe Slloake mbi rregullimin e detyrimeve reciproke në marrëdhëniet e pagesave deri më 31 dhjetor 1991 (Tiranë, më 23 janar 1992).

13. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Çeke dhe Slloake mbi pagesat tregtare reciproke deri më 1 janar 1992 (Tiranë, më 23 janar 1992).

14. Marrëveshja nënshkruar me shkëmbim notash mbi vendosjen e regjimit të vizave ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Çekoslloake (Tiranë, më 5 dhjetor 1961, Pragë, më 9 dhjetor 1961).